



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Prot. 27

Tiranë, më 10.1.2024

Vendim nr. 4 datë 10.1.2024

“Për strukturën e organikën dhe për emërimin e punonjësve kërkimorë-shkencorë, ndihmës tekniko-shkencorë dhe të administratës ndihmëse të instituteve të albanologjisë”

Referuar nenit 19 të Ligjit nr. 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë*;

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 338 datë 31.5.2023 *Për mbylljen e veprimtarisë së Akademisë së Studimeve Albanologjike dhe riorganizimin e njësive kryesore të saj*; të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 821 datë 28.12.2023 *Për ngritjen dhe organizimin e njësive të përhershme të kërkim-studimit në albanologji pranë Akademisë së Shkencave në Republikën e Shqipërisë*;

Në vijim e zbatim të vendimit nr. 61 datë 23.10.2023 të Asamblesë *Për ngritjen dhe organizimin e njësive të kërkim-studimit në shkencat albanologjike pranë Akademisë së Shkencave*;

Në përputhje me nenet 47 e 48 të Statutit të Akademisë së Shkencave (i rishikuar, me vendim të Asamblesë, datë 8.1.2024);

Kryesia, në mbledhjen e saj të datës 10.1.2024

Vendosi:

1. Struktura, organika, lista emërore dhe niveli i pagave i punonjësve kërkimorë-shkencorë të instituteve të albanologjisë që ngrihen pranë Akademisë së Shkencave si njësi të përhershme të kërkim-studimit (Instituti i Arkeologjisë, Instituti i Historisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Instituti i Antropologjisë dhe Qendra e Studimit të Arteve) të jenë si në *Lidhjet 1 dhe 2* bashkëngjitur.

2. Struktura, organika, lista emërore dhe niveli i pagave i punonjësve ndihmës tekniko-shkencorë të tyre të jenë si në *Lidhjen 3* bashkëngjitur.

3. Struktura, organika, lista emërore dhe niveli i pagave i punonjësve të administratës ndihmëse të tyre të jenë si në *Lidhjet-4,a dhe 4,b*, bashkëngjitur.
4. Ngarkohet sektori i financës për përlogaritjen e pagave në shifra absolute për punonjësit e njësive të reja sipas pikave 1, 2 dhe 3 të këtij vendimi deri më datën 20 janar 2024.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: Kryesia, kancelari, juristi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe të zbatohet deri më 20.1.2024.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

